



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, paragrafi 1, shkronja (b) dhe (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" nenit 15, lidhur me nenet 28 dhe 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën, 27.11.2023, miraton këtë:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-4813, të datës 27.06.2013

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet-plotësohet vendimit, 01-Nr-16-4813 i datës 27.06.2013, për dhënien pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private, me qëllim të korigjimit-përmirësimit të numrave të parcelave dhe sipërfaqeve të pronave private dhe publike.

Neni 2

Nenit 1, të vendimit bazik me numër të protokollit 01-Nr-16-4813, të datës 27.06.2013, ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

JEPET PËLQIMI- për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private të cilat gjenden te vendi i quajtur "Fshat", zona kadastrale Mushtisht: parcela, P-72116029-03764-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1997m², nga sipërfaqja e përgjithshme jepen 191m², parcela P-72116029-03764-2, me sipërfaqja te përgjithshme prej 24m², parcela, P-72116029-03008-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1004m², nga sipërfaqja e përgjithshme jepen 53m², parcela, P-72116029-03008-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 4m² dhe parcela, P-72116029-03008-3, me sipërfaqe të përgjithshme prej 20m², nga sipërfaqja e përgjithshme jepen 14m², që të gjitha P.Sh. "Rrugë publike e pakategorizuar", **Ju jepen** bashkëpronarëve; Hisen Bajram Durmishi, Ali Bajram Durmishi dhe Jeton Ismet Durmishi, që të tret nga fshati Mushtisht, **ndërsa:** parcela, P-72116029-03011-5, me sipërfaqe të përgjithshme prej 29m², në emër të Jeton Ismet Durmishi, parcela, P-72116029-03012-2, me sipërfaqe prej 32m² parcela P-72116029-02845-1, me sipërfaqe prej 211m² dhe parcela P-72116029-02845-3, me sipërfaqe prej 14m², në emër të bashkëpronarëve: Hisen Bajram Durmishi, Ali Bajram Durmishi dhe Jeton Ismet Durmishi, që të tret nga fshati Mushtisht, **I jepen** Komunës së Suharekës, në emër të këmbimit, për rregullimin e infrastrukturës rrugore, për interes të përgjithshëm publik.

Neni 3

Ndërsa pjesët tjera kompletë të vendimit bazë me numër 01-Nr-16-4813 i datës 27.06.2013, mbesin të pa ndryshuara.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 010-74252
Më datë 27.11.2023



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Mr. **ë Bexhet KUÇI**